

V E N D I M
Nr. 1, datë 31.1.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 30.1.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, me dyer të hapura, çështjen nr. 216/6 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË
SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zoti Viktor Gumi, me autorizim.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE, në mungesë.

3. MINISTRIA E FINANCAVE, në mungesë.

4. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE, në mungesë.

5. “BOAR”, sh.p.k., përfaqësuar nga zoti Bardhyl Meçe, president i shoqërisë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i neneve 6 e 30 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/a e 145/2 të Kushtetutës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, ka parashtruar këto shkaqe për papajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 6 e 30 të ligjit të mësipërm:

- Zbatimi i neneve 6 e 30 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, vjen në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës, pasi rëndon pozitën financiare të shoqërisë;

- Dispozitat e kundërshtuara vijnë në kundërshtim me nenin 155 të Kushtetutës, sepse, me to, ligjit të mësipërm i jepet fuqi prapavepruese.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, parashtroi se neni 30 i ligjit të mësipërm nuk vjen në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës, sepse nga formulimi i tij del qartë se organizatori nuk detyrohet të paguajë shumën e parashikuar në nenin 6 pa mbaruar afati 10-vjeçar i lejes së dhënë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Petrit Plloçi, përfaqësuesin e kërkuarit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen,

V Ë R E N:

“BOAR-FUAT” sh.p.k., që ushtron veprimtarinë e organizimit të lojës së fatit – bingo në qytetin e Librazhdit, ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, kundër palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me objekt anulimin e aktit administrativ – aktbllokimit datë

18.3.2002, të nxjerrë nga pala e paditur.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka arritur në përfundimin se për zgjidhjen e kësaj çështjeje duhet të zbatohet ligji nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”. Gjykata, duke çmuar se nenet 6 e 30 të këtij ligji nuk janë në pajtim me Kushtetutën, në bazë të nenit 145/2 të saj, ka pezulluar gjykimin dhe ia ka dërguar çështjen Gjykatës Kushtetuese.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata Kushtetuese bashkohet me mendimin e shprehur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 30 të ligjit të mësipërm, për këto arsye:

Neni 155 i Kushtetutës parashikon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare, kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj dhe se, në këto raste, ligjit nuk mund t’i jepet fuqi prapavepruese.

Për sa më sipër, çështja që shtrohet për zgjidhje është nëse ligji i atakuar, përfshihet në kategorinë e ligjeve të parashikuara në nenin 155 të Kushtetutës. Për këtë qëllim, duhet përcaktuar nëse pagesa që kërkon neni 6 i ligjit të vitit 2000, si kusht për dhënien e lejes, do të konsiderohet taksë, tatim apo detyrim tjetër financiar, kombëtar e vendor.

Sipas nenit 9 të ligjit të sipërpërmendur të vitit 2000, fitimet që organizatori i lojërave të fatit realizon nga ushtrimi i veprimtarisë së vet, janë të tatueshme, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. Pagesa që kërkon neni 6 është pagesë fikse dhe, duke qenë e tillë, nuk është tatim. Përveç kësaj, pagesa që kërkon kjo dispozitë nuk është as taksë, sepse për këtë lloj veprimtarie të palës kërkuese, në ligjin nr. 8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave”, parashikohet një taksë, e cila është e ndryshme nga pagesa që kërkon neni 6 i ligjit të vitit 2000. Konkretisht pika 17 e nenit 2 parashikon se në taksat kombëtare, ndërmjet të tjerash, bën pjesë edhe “taksa e regjistrimit për ushtrimin e llotarive, të konkurseve parashikuese dhe lojërave të fatit”, ndërsa sipas nenit 6/I/nj, ku caktohet niveli i taksave, kjo lloj takse është 50 mijë lekë në vit. Ndërsa, ligji nr. 8977, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligji nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, në dispozitat respektive, ku parashikojnë llojet e taksave, për veprimtarinë që ushtron pala kërkuese, nuk parashikojnë ndonjë taksë. Për pasojë, detyrimi për pagimin e shumës 10 milionë lekë, si kusht për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë, duhet kategorizuar si detyrim financiar, pra në kategorinë e tretë të detyrimeve që parashikon neni 155 i Kushtetutës.

Çështja tjetër që duhet të trajtohet është nëse neni 30 i ligjit të vitit 2000, i jep këtij ligji fuqi prapavepruese.

Lidhur me nocionin e fuqisë prapavepruese doktrina ka pranuar se kjo është e pranishme në rastet kur një normë ligjore zbatohet për gjëra tashmë të vendosura në të kaluarën. Në aspektin kushtetues, ligji me fuqi prapavepruese është i kundërshtueshëm nëqoftëse cenon të drejtat e fituara me ligjet ekzistuese ose krijon një detyrim të ri, përsa u përket transaksioneve të shkuara.

Për këtë rast rezulton se palës kërkuese i është dhënë leja e ushtrimit të veprimtarisë në bazë të ligjit të vitit 1994, për një afat 10-vjeçar dhe ky afat nuk ka përfunduar. Në bazë të ligjit të vitit 1994, të përmendur më sipër, subjektet që ushtrojnë këtë veprimtari nuk kishin ndonjë detyrim për të paguar, si kusht për marrjen e lejes, ndërkohë që sipas nenit 6 të ligjit të vitit 2000 për marrjen e lejes, organizatori paguan një shumë prej 10 milionë lekësh. Këtë pagesë, neni 30 i ligjit të vitit 2000, e kërkon edhe për lejet e dhëna në bazë të ligjit të vitit 1994, afati i të cilave nuk ka përfunduar. Në këtë mënyrë, neni 30 i ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000, “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, duke parashikuar zbatimin e këtij ligji të ri edhe për lejet e dhëna me ligjin e mëparshëm, i jep këtij ligji fuqi prapavepruese, gjë që vjen në kundërshtim me nenin 155 të Kushtetutës.

Në këto kushte, neni 30 i ligjit të mësipërm duhet të shfuqizohet, si i papajtueshëm me Kushtetutën.

Lidhur me nenin 6 të ligjit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kjo dispozitë, në vetvete, nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Për pasojë, sipas kësaj dispozite kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 68 e 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën, të nenit 30 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”;
- rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 6 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kam mendim të kundërt me vendimin e shumicës, që ka arritur në përfundimin për papajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 30 të ligjit nr. 8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”. Ky nen nuk ka përmbajtje antikushtetuese dhe, si i tillë, nuk duhet të shfuqizohet.

Argumenti i vetëm për pakushtetutshmërinë e këtij neni është se ai i jep ligjit fuqi prapavepruese dhe për këtë bie në kundërshtim me nenin 155 të Kushtetutës.

Për të arritur në një përfundim të drejtë për përmbajtjen e nenit 30 të ligjit dhe nëse zbatimit të tij i jepet ose jo fuqi prapavepruese, është e nevojshme të analizohet kjo dispozitë në lidhje me dispozitat e tjera të ligjit dhe me qëllimin e tij. Neni 30 ka këtë përmbajtje: “Ripërtëritja vjetore e lejeve për licencat ekzistuese, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj”.

Me këtë formulim ligjvënësi ka patur si qëllim të ruajë edhe për të ardhmen konceptin e ripërtëritjes vjetore të lejeve, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 8 të ligjit të mëparshëm nr. 7871, datë 9.11.1994 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”, shfuqizimi i të cilit parashikohet në nenin 31 të ligjit në fuqi. Pra, ky ligj para se të bëjë shfuqizimin e ligjit të mëparshëm ka marrë prej tij kriterin e përtëritjes vjetore, veprim ky që kryhet pa pagesë nga subjekti i licencuar.

Ky kriter ligjor i përtëritjes vjetore të lejeve pa shpërblim, i miratuar nga ligji në fuqi, ka si qëllim të ruajë vazhdimësinë e licencave, por pa dëmtuar subjektet e licencuara më parë. Kështu, subjekti që ka përfituar licencën sipas ligjit të mëparshëm, me afat 10-vjeçar, kundrejt detyrimit monetar të caktuar, do të vazhdojë ta ruajë këtë të drejtë deri në fund të afatit, me kusht që nga ana e shtetit të bëhet kontrolli i përtëritjes vjetore. Duke qenë se ky kontroll nuk shoqërohet me detyrim monetar, i cili është paguar një herë kur është marrë licenca, nuk mund të arrihet në përfundimin se neni 30 i ligjit, ka fuqi prapavepruese.

Përfundimi për pakushtetutshmërinë e nenit 30 vetëm për shkak të fuqisë prapavepruese, nuk është i bazuar edhe për arsye të tjera. Të njëjtën përmbajtje ka edhe neni 6 i ligjit, që parashikon se leja për organizimin e lojërave të fatit jepet për një periudhë 10-vjeçare, për marrjen e të cilës, organizatori paguan një shumë prej 10 milionë lekësh. Edhe për këtë nen është kërkuar shfuqizimi i tij si antikushtetues për të njëjtin shkak, atë të fuqisë prapavepruese të tij, por Gjykata Kushtetuese nuk e vlerëson të tillë. Po t'i qëndrohet argumentit që përdoret për ta quajtur antikushtetues nenin 30, e njëjta gjë mund të thuhet edhe për nenin 6, si edhe për nenin 11, i cili parashikon ripërtëritjen e lejës kundrejt pagesës prej gjysmës së shumës së parashikuar në nenin 6, për afat 5-vjeçar. Po të bëhet interpretimi i përmbajtjes së këtyre neneve nën frymën e interpretimit që shumica i bën nenit 30 të ligjit, del se, si rezultat i fuqisë prapavepruese të tyre, dëmi që u shkaktohet subjekteve të licencuara me ligjin e mëparshëm është jo vetëm real, por edhe shumë herë më i madh, në raport me nenin 30, i cili parashikon ripërtëritjen vjetore pa shpërblim.

Mendoj, se për të bërë një interpretim sa më të saktë të këtyre dispozitave, krahasuar me kërkesat e nenit 155 të Kushtetutës, duhet nxjerrë në dukje qëllimi që ka ligji, i përcaktuar ky edhe në nenin 30, përmbajtja e të cilit, po të shihet në lidhje me dispozitat e tjera, synon që marrëdhëniet e krijuara nga veprimtaria e subjekteve të licencuara me ligjin e mëparshëm, të vazhdojnë të rregullohen nëpërmjet ligjit në fuqi, por pa detyrimin për të paguar shumën e caktuar për marrjen e licencës, e cila është paguar një herë për një afat 10-vjeçar.

Në një përfundim të tillë arrihet edhe nga fakti se detyrimi për të paguar për marrjen e licencës është një detyrim financiar që bëhet në një kohë të caktuar (në marrjen e licencës) dhe konsiderohet i

paguar brenda periudhës 10-vjeçare. Duke qenë i një natyre të tillë, në dallim nga taksat e tatimet për të cilat ka kritere të veçanta, ky detyrim paguhet vetëm një herë.

Përderisa neni 30 i ligjit nuk krijon një detyrim të ri për ato subjekte që kanë fituar më parë të drejtën e marrjes së licencës, në rastin e një konflikti eventual, gjykata që shqyrton çështjen do ta zgjidhë atë në përshtatje me kërkesat e kësaj dispozite dhe qëllimin e ligjit, i cili e konsideron të pambaruar afatin 10-vjeçar. Në këto kushte, gjykata që shqyrton çështjen, nëpërmjet interpretimit të ligjit, duhet ta zgjidhte vetë atë pa qenë nevoja t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese.

Duke e parë këtë problem në një aspekt më të gjerë se përmbajtja e dispozitës së atakuar, mund të mendohet se kjo e fundit është antikushtetuese për shkak të paqartësisë dhe të kontradiktave që ka me dispozita të tjera të ligjit. Ndonëse ky aspekt nuk trajtohet në vendimin e shumicës, duke u mjaftuar vetëm me argumentin për fuqinë prapavepruese, vlen të theksohet se në rastin konkret nuk evidentohet antikushtetutshmëria as në këtë drejtim. Kjo për faktin se dispozita ligjore mund të konsiderohet antikushtetuese kur paqartësitë ose kontradiktat që ka, janë të tilla që bëjnë të pamundur zbatimin praktik të saj. Por, përderisa kjo dispozitë zbatohet duke iu bërë interpretimi në përshtatje me qëllimin e ligjit që rregullon këtë veprimtari, siç u përmend më lart, antikushtetutshmëria e nenit 30 nuk gjen mbështetje as në këtë aspekt.

Përfundimisht mendoj se zgjidhja më e drejtë do të ishte lënia në fuqi e nenit 30 duke argumentuar se përmbajtja e tij nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën, sepse nuk i është dhënë fuqi prapavepruese.

ANËTAR
K. Peçi